



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:145200

Datë: 07.06.2024

Numri i dokumentit: 05797007

KPPP.nr. 2155/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me gjyqtarin Florent Zeqiri, në çështjen përbarimore të kreditorit Korporata Energjetike e Kosovës Sh.A. – Divizioni i Furnizimit në Gjakovë kundër debitorit Restorant N.P.T.SH “Mergimi” me seli në Rahovec, fshati Gexhë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër aktvendimit mbi lejimin e përbarimit E.nr. 46/2012 të datës 01.02.2012 të lejuar nga ish-Gjykata Komunale në Rahovec, jashtë seancës, me datë 07.06.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit Restorant N.P.T.SH “Mergimi” me seli në Rahovec ashtu që Urdhri Përbarimor P.nr. 719/23 i datës 03.11.2023, i lejuar nga Përbaruesi Privat Gjokë Radi, ANULOHET.

A r s y e t i m

Ish-Gjykata Komunale në Rahovec, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Korporata Energjetike e Kosovës Sh.A. – Divizioni i Furnizimit në Gjakovë, me datë 01.02.2012 ka lëshuar aktvendimin E.nr. 46/2012 me të cilin ka lejuar përbarimin në bazë të dokumentit faturë nr. 80005954 ë datës 04.01.2012, ashtu që është detyruar debitori që në afat prej shtatë (7) ditësh nga dita e dorëzimit të urdhrin, në emër të borxhit të papaguar, t’ia paguaj kreditorit detyrimin në vlerë prej 1,690.74 EUR, me kamatë ligjore prej 3.5 %, si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore që do të krijohen prej momentit të dorëzimit të këtij propozimi për përbarim.

Debitori, brenda afatit ligjor e ka kundërshtuar në tërësi urdhrin për lejimin e përbarimit me arsyetim se në propozimin për përbarim, kreditori nuk e ka sqaruar fare se për cilin muaj

kërkohej borxhit dhe sa është borxhi real, e po ashtu ka shtuar se borxhi që derivon nga kjo faturë është përfshirë në parashkrim.

Përgjigje në prapësim ka paraqitur kreditori duke theksuar se nga transaksioni DGJ – 80005954 i datës 03.06.2015 shihet se debitori ka akumuluar borxhin nga data 29.12.2007 e deri më datë 19.01.2012 dhe se i njëjti, ka bërë pagesa të kohë pas kohshme në shuma të ndryshme të cilat e kanë ndaluar afatin e parashkrimit. Andaj ka kërkuar nga gjykata që të vendos në bazë të faturës e cila është dokument i besueshëm dhe të refuzohet në tërësi prapësimi i debitorit.

Gjykata Themelore në Gjakovë – Dega në Rahovec me aktvendimin E.nr. 46/2012 të datës 29.09.2015 ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit, ashtu që ka shfuqizuar aktvendimin mbi lejimin e përmbarimit E.nr. 46/2012 të datës 01.02.2012 sa i përket borxhit në shumë prej 776.89 EUR për shkak të parashkrimit, ndërsa në pikën II të dispozitivit, ka lënë në fuqi pjesën tjetër të aktvendimit mbi lejimin e përmbarimit për shumën prej 913.85 EUR.

Gjykata e Apelit e Kosovës, me Aktvendimin Ac.nr. 310/2016 të datës 22.04.2016, ka aprovuar si të themeltë ankesën e kreditorit Korporata Energjetike e Kosovës Sh.A. – Divizioni i Furnizimit në Gjakovë dhe lëndën e ka kthyer në rivendosje pranë gjykatës së shkallës së parë. Në arsyetimin e saj, gjykata e shkallës së dytë ka theksuar se në shkresat e lëndës nuk gjendet aktvendimi i gjykatës me të cilin është vendosur lidhur me propozimin për lejimin e përmbarimit, andaj ka sqaruar se kundërshtimi i debitorit mund të shqyrtohet vetëm pasi që të vendoset lidhur me propozimin për lejimin e përmbarimit.

Në rivendosje, Gjykata Themelore në Gjakovë – Dega në Rahovec, me aktvendimin Cp.nr. 215/2016 të datës 02.06.2020 ka obliguar kreditorin që të specifikoj saktë borxhin për të cilin obligohet debitori nën pasojën se propozimi për përmbarim do konsiderohet i tërhequr nëse nuk veprohet sipas këtij aktvendimi në afat prej tre (3) ditësh nga pranimi i të njëjtit. Ndërsa kreditori, me parashtrësën e datës 11.09.2020 ka bërë precizimin e borxhit, duke njoftuar gjykatën se borxhi i debitorit sipas transaksionit të konsumatorit 80005954 është në vlerë prej 2,601.49 EUR.

Po kjo gjykatë, me aktvendimin CP.nr. 215/2016 të datës 29.08.2023, është shpallur jo kompetente në pikëpamje lëndore, dhe lëndën e ka transferuar për shqyrtim të mëtejshme pranë Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë.

Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, gjeti se tanimë objekt shqyrtimi është vendosja sipas prapësimit të palës debitore të parashtruar me datë 08.01.2014 ashtu që pas shqyrtimit të pretendimeve të palëve ndërgjyqëse, shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës si dhe duke marrë për bazë vërejtjet sipas Aktvendimit të Gjykatës së Apelit Ac.nr. 310/2016 të datës 22.04.2016, në kuptim të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa në par.2 të po këtij neni, si dokument i besueshëm sipas ligjit konsiderohen *“ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave”*, ndërsa me nenin 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “.*

Gjykata nga shkresat e lëndës konstatoi se kreditori, propozimin për përmbartim e ka iniciuar në bazë të faturës nr. 80005954 ë datës 04.01.2012 dhe për të cilën faturë, kreditori nuk ka ofruar asnjë dëshmi se debitori të njëjtën e ka pranuar duke mos e kundërshtuar detyrimin sipas faturës, pasi që tek pjesa e nënshkrimit të faturës nga debitori, kolona në fjalë është e zbrazët dhe nuk identifikohet asnjë shenjë se debitori është vënë në dijeni lidhur me të njëjtën. Se pranimi i faturës nga ana e debitorit dhe mos kundërshtimi i saj, ka paraqitur para kusht për arritshmërinë e borxhit që derivon nga kjo faturë pasqyrohet edhe në pjesën e pasme të kësaj fature, ku vet kreditori, ka përcaktuar se reklamimi eventual i kësaj fature nga pranuesi duhet bërë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të saj.

Në anën tjetër, gjykata pati parasysh faktin se kreditori, duke iu përgjigjur konkluzionit CP.nr. 215/16 të datës 02.06.2020 ka bashkangjitur ekstraktin nga librat afarist me nr. transaksioni DGJ-80005954 të datës 10.09.2020, ku borxhi i debitorit figuron në vlerë prej 2,601.49 EUR, por që gjykata, në rastin konkret, është e kufizuar vetëm në shqyrtimin e përshtatshmërisë së dokumentit faturë nr. 80005954 ë datës 04.01.2012 i cili në propozimin për përmbartim është i përcaktuar si dokument mbi bazën e të cilit është lejuar përmbartimi.

Rrjedhimisht, përderisa pala kreditore nuk ka paraqitur kërkesë pranë gjykatës për plotësimin e propozimit për përmbarim duke shtuar si dokument të besueshëm edhe ekstraktin nga librat afarist me nr. transaksioni DGJ-80005954, i cili sipas nenit 29 par.1 nën-par. 1.2 të LPP-së paraqet bazë të veçantë për lejimin e përmbarimit dhe përderisa në shkresa të lëndës nuk gjendet ndonjë aktvendim mbi lejimin e plotësimit të përmbarimit të lëshuar nga Gjykata Themelore në Gjakovë si organ përmbarues, këtu Gjykata Komerciale, si gjykatë që vendos sipas mjeteve juridike, kufizohet vetëm në vlerësimin e përshtatshmërisë së dokumentit mbi bazën e të cilit është lejuar përmbarimi, dhe i cili dokument, siç u elaborua më lartë, nuk ka tipare të përmbarueshmërisë pasi që në shkresat e lëndës nuk ka asnjë provë të vetme nga e cila vërtetohet se debitori ka pranuar faturën në fjalë dhe të njëjtën nuk e ka kundërshtuar.

Gjykata morri për bazë vërejtjet e dhëna nga Gjykata e Apelit e Kosovës përmes aktvendimit Ac.nr. 310/2016 të datës 22.04.2016 që fillimisht të vërtetohet se a është marrë aktvendim mbi lejimin e propozimit për përmbarim të kreditorit, dhe nga shkresat e lëndës, gjeti se në pjesën e pasme të propozimit për përmbarim të kreditorit, evidentohet vula katrore e ish-Gjykatës Komunale në Rahovec, nga e cila dëshmohet se është lejuar përmbarimi sipas propozimit të kreditorit dhe lënda ka marrë shenjë E.nr. 46/2012.

Si përfundim, meqenëse fatura nr. 80005954 ë datës 04.01.2012 mbi bazën e të cilit është lejuar përmbarimi nuk ka tipare të përmbarueshmërisë, gjykata nuk u lëshua në vlerësimin e pretendimeve të tjera të ngritura nga debitori si në prapësim, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit vendosi jashtë seancës gjyqësore.

Nga sa më sipër, në mbështetje të nenit 43 dhe 73 të LPP-së, si dhe nenit 13, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 2155/23, datë 07.06.2024

Gjyqtari

Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.